



## Mëkati dhe mëkati fillestar

### Description

**Philip L. Quinn**

Fragment i shkëputur nga: [“A Companion to Philosophy of Religion \(Blackwell Companions to Philosophy\)”](#) by Philip L. Quinn and Charles Taliaferro (Paperback – Jun 25, 1999), f. 541-548

Sipas një koncepti të hershëm, gabimet njerëzore janë shkelje të cilat të fëlliqin ose njollosin, d.m.th. prodhojnë forca ndotëse të cilat në një formë apo tjetrën e infektojnë nga jashtë mëkatarin. Gabimet njerëzore nuk duhen identifikuar domosdoshmërisht me veprimet e liga moralisht, për këtë arsye edhe ndotja që ato shkaktojnë nuk duhet identifikuar doemos me fajin moral. Shërimi nga një ndotje e tillë mund të jetë një ritual purifikimi, për rrjedhojë nuk është e thënë që ajo të jetë një reagim i duhur ndaj fajit moral. Gjithsesi, në rastet kur shkeljet njerëzore konceptohen brenda kontekstit të një marrëdhënieje të caktuar me një hyjni, atëherë është e natyrshme ti shohësh ato si një ofendim ndaj vullnetit hyjnor. Po ashtu edhe në rastet kur hyjnia konceptohet si moralisht i përsosur, atëherë është e natyrshme që gabimet njerëzore të shihen si veprime të liga morale të cilat prodhojnë ndjesinë e fajit. Koncepti i mëkatit është koncepti i gabimit njerëzor i cili përbën një ofendim ndaj Zotit moralisht të përsosur dhe që në të njëjtën kohë shoqërohet edhe me ndjesinë e fajit.

Koncepti i mëkatit gjen një përkrahje të natyrshme në religjionet e mëdha monoteiste, Judaizmin, Krishterimin dhe Islamin. Të tre këto religjione ndajnë idenë se mëkatet janë veprime personale të cilat bien në kundërshtim me vullnetin e hyjnisë i cili është moralisht i përsosur. Në Biblën hebraike këto mëkate përbëjnë një devijim nga normat e shenjtërisë të cilat përcaktojnë marrëdhënien ndërmjet Jahvehut dhe popullit të zgjedhur. Sipas Dhjatës së Re, Jezusi mëson se veprimet e gabuara individuale ofendojnë Atë të cilin ai e quante Ati i tij. Kurani i paraqet mëkatet individuale si veprime që kundërshtojnë Allahun të cilat e kanë burimin nga fodullëku njerëzorë. Në pjesën e parë të këtij artikulli do të flasim për mëkatin individual.

Doktrina e mëkatit fillestar është veçanërisht e krishterë. Përligjja shkrimore e kësaj doktrine gjendet në letrat e Palit, dhe interpretimi i tyre nga Agustini, gjatë polemikës së tij me Pelagianët, pati një ndikim të

thellë në krishterimin perëndimor. Seksioni i dytë i këtij artikulli i është kushtuar konceptit Agustinian për mëkatin fillestar dhe përpunimit të kësaj ideje nga Anselm of Canterbury dhe Jonathan Edëards. Sipas Agustinit, Rënia e Adamit dhe Evës, e treguar në kapitullin e tretë të librit të Zanafillës, kishte sjellë pasoja shkatërrimtare mbi racën njerëzore. Të gjithë pasardhësit e çiftit të parë njerëzor, përjashtojë Jezusin dhe nënën e tij, kishin trashëguar nga Adami dhe Eva fajin për mëkatin e kryer prej tyre e në këtë mënyrë të gjithë ata kishin lindur duke mbajtur mbi vete peshën e mëkatis fillestarë. Ky koncept shfaqet si moralisht problematik për shkak se ai i vesh të gjithë racës njerëzore përgjegjësin dhe fajin për mëkatin fillestarë. Seksioni përmbjllës i këtij artikulli fokusohet mbi alternativat e mundshme të konceptit të Agustinit ashtu siç janë shtruar ato nga Xhon Loku, Imanuel Kanti, Soren Kierkegardi dhe Richard Sëinburne.

## Mëkati individual

Mëkate individuale quhen ato veprime njerëzore të cilat ofendojnë Perëndinë: ato janë veprime të cilat shkojnë ndesh me vullnetin apo urdhëresat hyjnore. Meqenëse Zoti, në religjionet më të mëdha botërore, konceptohet si një qenie moralisht e përsosur, rrjedhimisht çdo veprim i gabuar moralisht është e kundërta e vullnetit të Zotit për pasojë ai është një gjynah. Sipas urdhëresave etike hyjnore, një veprim është moralisht i gabuar vetën nëse ai është në kundërshtim me urdhëresat hyjnore. Sipas këtij këndvështrimi, nëse Zoti nuk ekziston dhe për rrjedhojë as urdhëresat hyjnore, atëherë asnjë veprim nuk mund të quhet i gabuar apo i mëkatshëm.

Shumë besimtarë nuk pajtohen me këtë koncept, sipas shumicës prej tyre një pjesë e mirë e moralitetit është e pavarur nga ekzistenca dhe vullneti i Zotit. Nuk janë ndalesat hyjnore ato që i shndërrojnë akte të tilla si vrasja, tortura apo përdhunimi në veprime të gabuara: qëllimi i ndalesave hyjnore është që të fuqizojnë një i cili është i pavarur nga këto ndalesa. P.sh. vrasja vështirë se mund të quhet një veprim i pamoralshëm vetëm për shkak se është i ndaluar nga Zoti; ajo është njëkohësisht një veprim i gabuar përse i përket viktimës si dhe përse i përket Zotit. Por vrasja do të vazhdonte të ishte një veprim moralisht i gabuar edhe sikur Zoti të mos ekzistonte. Për veprime të këtij lloji gabimi moral është i pavarur nga mëkatshmëria.

Jo të gjitha veprimet i përkasin kësaj kategorie. Është moralisht e gabuar të mos i shprehësh mirënjohje mirëbërësve. Nëse ne jemi krijesa të Zotit dhe jetët tona në përgjithësi janë të mira, atëherë ne jemi të detyruar që ti shprehim mirënjohje Zotit për dhuratën e jetës. Nëse Zoti nuk do të ekzistonte atëherë jeta nuk do të ishte një dhuratë, për rrjedhojë ne nuk do të ishim të detyruar ti shprehim mirënjohjen askujt për jetën tonë. Kështu që disa gjëra janë të tilla që si pasaktësia e tyre morale ashtu edhe të qenurit e tyre mëkat varen nga ekzistenca dhe veprimet e Zotit. Për veprime të tilla pasaktësia morale e tyre nuk është e pavarur nga të qenurit e tyre mëkat.

Për pasojë, sipas këndvështrimit të shumicës, mund të shquajmë dy lloj mëkatesh individuale. Ekzistojnë disa veprime të cilat janë moralisht të gabuara pavarësisht nga ekzistenca apo jo e Zotit si edhe veprime të tjera të cilat janë mëkate individuale për arsye se Zoti ekziston.

Në të njëjtën mënyrë mund të shquajmë dhe dallimet ndërmjet një mëkati objektiv dhe një mëkati subjektiv.

Një njeri i cili kryen qëllimisht një veprim ofendues ndaj Zotit, mëkaton në mënyrë të qëllimshme dhe për rrjedhojë mban mbi vete fajin përkatës. Ndërsa një individ i cili vepron diçka të cilën ai nuk beson se është në kundërshtim me urdhëresat e Zotit atëherë, mëkaton në mënyrë subjektive dhe në përpjesëtim me këtë merr edhe fajësinë. Besimtarët të cilët besojnë se ndërgjegjja gabimtare është e lidhur me vullnetin duhet që të pranojnë edhe ato raste në të cilat, në bazë të një besimi të gabuar lidhur me saktësinë morale të një vepre, një person vepron atë që është subjektivisht dhe jo objektivisht e gabuar moralisht, për këtë arsye ai mëkaton subjektivisht dhe jo objektivisht. Faji që vjen si rrjedhojë e mëkatis individual e bën njeriun përgjegjës për ndëshkimin hyjnor nëse mëkatar ka përmbushur kushtet dhe përgjegjësitë e duhura për veprimin e tij. Një person i cili mëkaton njëkohësisht objektivisht dhe subjektivisht dhe besimi i tij për atë që përbën ose jo ofendim për Zotin është krejtësisht i justifikuar mund të bëhet meritore për një dënim të ashpër. Ndërsa një person i cili mëkaton objektivisht dhe jo subjektivisht dhe mungesa e bindjeve të sakta për atë që përbën ose jo ofendim për Zotin nuk vjen si pasojë e paditurore së justifikuar mund të meritojë pak ose aspak dënim.

Të krishterët të cilët besojnë se ferri është një vend ku zbatohet ndëshkimi i përhershëm për mëkatis e mëdha individuale shpeshherë përpiqen ta justifikojnë besimin në këtë doktrinë të ashpër duke pohuar se mëkatis e mëdha personale janë një ofendim infinit ndaj Zotit. Vetëm një ofendim infinit ndaj Zotit është i mjaftueshëm për të justifikuar një dënimin infinit meqenëse ai është i shtrirë në përhershmeri. Por është e vështirë të kuptohet ideja e një mëkatis individual i cili është pafundësisht fyes ndaj Zotit, po ashtu është shumë e vështirë për tu besuar edhe hamendësimi se njeriu mëkatar mund të meritojë një ndëshkim të përhershëm nga hyjnia moralisht i përsosur. Të krishterët nuk kanë nevojë të përvetësojnë këtë koncept kaq të ashpër për ferrin meqenëse tradita e tyre lejon mundësinë edhe për alternativa të tjera. Nëse ato do të zgjedhin një alternativ tjetër më pak të ashpër, ato mund të pohojnë se marrëdhënia ndërmjet mëkatis individual, fajit përpara Zotit, dhe të merituarit e dënimit janë në mënyrë paralele dhe jo më pak problematike, nisur nga ana morale, se sa marrëdhënia ndërmjet keqbërjes, fajit moral, dhe të merituarit e sanksioneve të ndryshme. Sidoqoftë ky nuk është rasti i Agustinit dhe konceptit të tij për mëkatin fillestar.

## **Koncepti i Agustinit për mëkatin fillestar**

Zhvillimi i doktrinës së mëkatis fillestar fillon me historinë e rënies së Adamit dhe Evës ashtu siç tregohet ajo në kapitullin e tretë të librit të Zanafillës. Sipas kësaj historia kur çifti i parë njerëzorë e shkeli urdhërimin hyjnor për të mos ngrënë nga fryti i një peme të caktuar, Zoti i ndëshkoi ato me punë të rënda, vuajtje dhe vdekje. Fakti që edhe ne njerëzit e përjetojmë këtë ndëshkim është si pasojë e veprimit të çiftit të parë njerëzorë. Gjithsesi, kjo histori, e treguar tek libri i Zanafillës, nuk rrëfen se përjetimi i vuajtjes dhe vdekjes është ndëshkim për ne, po ashtu ajo nuk sugjeron se ne kemi trashëguar nga Adami dhe Eva barrën e fajit. Ideja e trashëgimit të mëkatis fillestar është një koncept që gjendet tek letrat e Palit dhe nuk është pjesë e historisë së treguar tek libri i Zanafillës.

Pali e lexonte biblën hebraike si një tekst i mbushur përplot me parashikime të cilat u realizuan gjatë

jetës së Jezu Krishtit. Tek letrat e Palit kontrasti i fuqishëm retorik midis figurës së Adamit dhe Krishtit fillon me këto fjalë: *“Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan”* (Romakëve 5:12). Nisur nga kjo ai del në përfundimin se: *“Në fakt, ashtu si nga mosbindja e një njeriu të vetëm të shumtët u bënë mëkatarë, ashtu edhe nga bindja e një të vetmi të shumtët do të bëhen të drejtë.”* (Romakëve 5:19). Kontrasti i balancuar me kujdes në pjesën e dytë të këtij verseti sugjeron se gjithë njerëzimi u bë fajtor si rezultat i mosbindjes së Adamit. Bindja (veprim i mirë) e një njeriu të vetëm (Krishti) ishte e tillë që përmes saj të gjithë do të (e ardhmja) bëhemi të drejtë në sytë e Perëndisë (status pozitiv etik), kështu që, nëse duhet të plotësojmë kontrastin, duhet të themi se mosbindja (vepër e keqe) e një njeriu tjetër (Adamit) duhet të jetë e tillë që përmes saj të gjithë ishin (e kaluara) bërë mëkatarë (status negativ etik). Kjo nënkupton se gjithë njerëzimi përftoi statusin negativ etik të të qenurit mëkatarë përmes mëkatit fillestarë të Adamit, e cila merr kuptim vetëm nëse supozojmë se faji është një diçka e cila transmetohet në një farë mënyre nga Adami tek pasardhësit e tij në një rrugë e cila i përngjan transferimit të drejtësisë nga Krishti tek ata të cilët përftojnë nga vepra e tij e shpengimit nga mëkati.

Agustini e shpreh qartësisht këtë hamendësim. Ai këmbëngul se: *“Kur çifti i parë njerëzor u ndëshkua nga Perëndia, e gjithë raca njerëzore, e cila do të ishte pasardhëse e Adamit përmes gruas së parë (Evës), ishte e pranishme tek njeriu i parë”* (City of God, f. 271). Sipas Agustinit të gjithë njerëzit ishin të pranishëm tek Adami sepse natyra njerëzore në vetvete ishte pranishme në farën e Adamit. Ai vazhdon më tej me arsyetimin e tij duke u shprehur se: *“për shkak se kjo natyrë njerëzore kishte qenë e njollosur nga mëkati, e dënuar me vdekje dhe drejtësisht e ndëshkuar, no man éas to be born of man in any ther condition”* (City of God, f. 279). Sipas këndvështrimit të Agustinit të gjithë ne jemi të lindur me njollën e mëkatit dhe drejtësisht të ndëshkuar, ky status është pjesë e asaj që në ditët tona mund ta quajmë dhurata gjenetike, meqenëse ajo është transmetuar gjenetikisht nga Adami tek pasardhësit e tij përmes farës mashkullore. Gjatë përpjekjeve të tij për të mbrojtur këtë doktrinë të habitshme kundër sulmeve të Pelagian-ëve të përfaqësuar nga Julian Eclanum, të cilët ishin kundër kësaj doktrine, Agustini shpesh mbështetej tek autoriteti i teksteve të Palit të tilla si Romakëve 5:12 dhe 5:19.

Shumë shkollarë bashkëkohorë të Biblës e kanë vënë në dyshim legjitimitetin e mbështetjes së Agustinit tek pasazhi 5:12 i librit të Romakëve. Ata janë argumentuar me faktin se Agustini e ka keqkuptuar këtë verset për shkak se ai e ka lexuar atë në gjuhën latine dhe jo në gjuhën origjinale greke. Për rrjedhojë, Agustini e kuptoi pasazhin në fjalë sikur ai pohonte se përmes një njeriu mëkati hyri në botë dhe përmes mëkatit vdekja, në këtë mënyrë vdekja preku çdo njeri, *in ëhom* all sinned (rather than in as much as all sinned), për rrjedhojë ai në mënyrë të gabuar hamendësoi se fjalia e fundit i kthehet një njeriu të vetëm, Adamit, gjë e cila dërgoi në përfundimin se mëkati i Adamit solli jo vetëm vdekje universale por edhe mëkat dhe faj universal. Qoftë edhe në rastin kur do të pranojmë për të saktë faktin se përfundimet e Agustinit nuk përkrahen nga pasazhi 5:12, përsëri kjo ide mbështetet nga pasazhi 5:19, gjë e cila bën që ideja në fjalë të ketë një farë mbështetje shkrimore. Këndvështrimi i Agustinit për mëkatin fillestar është pranuar nga shumica e mendimtarëve të krishterë për më shumë se njëmijë vjet. Kjo ide ka një ngjashmëri të habitshme me konceptin e hershëm të ndotjes që i infekton njerëzit duke ardhur nga jashtë. Të krishterët shpesh e përshkruajnë sakramentin e pagëzimit, i cili është një ritual purifikimi, si një pastrim të shpirtit nga forcat e liga të mëkatit fillestar.

Doktrina e Agustinin për mëkatin fillestar u përpunua më tej në shkrimet e teologëve filozof të mëdhenj të mesjetës të tillë si Anselmi. Në këndvështrimin e tij, çdo individ njerëzor është një përbërje metafizike që përfshin edhe një natyrë, e cila e bën njeriun krijesë njerëzore, si dhe një parim

individualizimi, i cili e bën njeriu një person të veçantë nga të tjerët. Mëkati fillestar është i përqendruar me natyrën njerëzore që në origjinën e ekzistencës së saj si një person, për këtë arsye ai është i lindur dhe i pashmangshëm. Ai konsiston në një vullnet të cilit i mungon sensi i orientimit për shkak se nuk është i nënshtruar nga vullnetit të Zotit. Anselmi është novator kur e karakterizon procesin në të cilin transmetohen si faji ashtu edhe mëkati nën terma të një parimi dyrrugësh (tëo-ëay principle) i cili është shkakësor por jo domosdoshmërisht biologjik. Ai pohon se: “Çfarë është personale i kalon natyrës, në këtë mënyrë çfarë është natyrore kalon tek njeriu” (The Virgin Conception and Original Sin, f. 202). Sipas pjesës së parë të këtij parimi, mëkati që bënë Eva me Adami bëri që natyra e tyre të bëhej mëkatore. Ndërsa sipas pjesës së dytë të parimit në fjalë, kjo natyrë mëkatore njerëzore bëri që pasardhësit e çiftit të parë njerëzorë të ishin mëkatarë dhe fajtorë që nga momenti i parë kur pajisen me një natyrë njerëzore. Mprehtësia logjike e Anselmit e lejoj atë të skiconte rrjedhoja tronditëse nga interpretimi që i bëri doktrinës së Agustinit. Kjo rrjedhojë tronditëse ka të bëjë me faktin që sipas tij fëmijët që vdisnin të papagëzuar, e nuk kishin kryer asnjë mëkat me vullnetin e tyre, por kishin vdekur vetëm të pajisur me barrën e mëkatit fillestar, ishin të ndëshkuar nga Zoti me përjashtimin nga Mbretëria e qiejve.

Kritikët e Agustinit dhe Anselmit kanë argumentuar se faji moral nuk është i transmetueshëm nga një person tek tjetri as në formë biologjike e as në ndonjë formë tjetër të mundshme. Nëse këto kritikë kanë të drejtë atëherë doktrina e mëkatit fillestar ka nevojë për rishikime. A ekziston ndonjë mënyrë për të kuptuar se si mund të jemi të gjithë fajtor për shkak të mëkatit fillestar të kryer nga njerëzit e parë pa pretenduar se mëkati është i transmetuar në mënyrë shkakësore nga çifti i parë njerëzorë? Teologjia federale e periudhës së Reformimit propozoi se gjinia njerëzore ishte fajtoreshë për mëkatin fillestar jo në sajë të ndonjë transmetimi shkakësor nga Adami tek ne por për pasojë të ngarkimit të fajit për gjithë njerëzimin nga ana e Perëndisë. Sipas kësaj rryme, Perëndia kishte qenë në një besëlidhje me Adamin, kryetari i federatës, ose përfaqësuesi i gjithë gjinisë njerëzore. Përmes Adami i gjithë njerëzimi ishte bërë pjesëmarrës në sprovën e mëkatit fillestar, kështu që faji për mëkatin e tij iu ngarkua, në mënyrë të drejtë, nga ana e Perëndisë, të gjithë njerëzimit për arsye se Adami, si përfaqësues i njerëzimit, e kishte kryer mëkatin dhe rrjedhimisht kishte thyer besëlidhjen me Perëndinë. Teologët e rrymës së federalizmit pohojnë se prirja njerëzore për të mëkatur është transmetuar nga Adami, gjithsesi ata këmbëngulin se shtrirja e pasojave të mëkatit fillestar nga Adami tek pasardhësit është kryer për shkak se Perëndia ia ka veshur gjithë njerëzimit fajin për këtë mëkat, për shkak se ata kishin thyer besëlidhjen me Të. Jonathan Esëards e përdori idenë e federalizmit gjatë mbrojtjes që i bëri doktrinës tradicionale të mëkatit fillestar. Ai e përshkroi Adamin në terma ligjor si “një person publik, apo kryetar i përbashkët” (Edëards 1970 [1758], f. 396).

Megjithatë nuk është aspak e qartë se si rishikimi i kësaj doktrine nga teologët e federalizmit mund ta shndërroj këtë të fundit në një doktrinë më pak problematike nga ana morale. Ndonëse praktikata tona morale dhe ligjore lejojnë raste kur një person mund të konsiderohet përgjegjës për veprimet e dikujt tjetër, gjithsesi këto praktika nuk lejojnë asnjë rast ku një njeri mund të quhet fajtor për gabimet e dikujt tjetër. Është e qartë se një njeri që të konsiderohet fajtor duhet të ketë kryer në vetë të parë një veprim të gabuar, po ashtu është e qartë se një individ nuk mund të performoj veprimin e dikujt tjetër. Për këtë arsye doktrina e mëkatit fillestar është e dënueshme paçka rishikimeve të propozuara nga teologët federalist. Filozofia moderne është e mbushur me kritikizëm ndaj kësaj doktrine.

## Kritikat filozofike bashkëkohore

Të krishterët do të kenë pak arsye për të përquar doktrinën e ashpër Agustiniane për mëkatin fillestar nëse do të vërtetohej pamjaftueshmëria shkrimore e një koncepti të tillë. Xhon Loku u përpoq të bënte pikërisht këtë gjë kur riinterpretoi tekstet Pauline të cituara nga Agustini. Në librin e tij *A Paraphrase and Notes on the Epistles of St. Paul*, ai përdori këtë metodë: fillimisht citonte versetin, më pas bënte një perifrazim të tij dhe në një futnotë të veçantë ai argumentonte saktësinë e perifrazimit të ofruar. Parafrazimi që ai ofroi në lidhje me pasazhin 5: 12 është si më poshtë: “Në mënyrë që tua bëj të qartë situatën e gjërave që nga fillimi, duhet të dini se përmes veprimit të një njeriu të vetëm, babait të të gjithëve ne, mëkati hyri në botë, përmes tij edhe vdekja, e cila ishte dënimi i përvetësuar për ofendimin e ngrënies së frytit të ndaluar, për këtë arsye pasardhësit e Adamit u bënë të vdekshëm. (Xhon Loku 1987 [1707], f. 523). Duke e zëvendësuar termin “u bënë mëkatarë” me termin “u bënë të vdekshëm”, Loku bllokoi si përfundimin se mëkati ishte trashëguar nga Adami tek pasardhësit e tij, po ashtu edhe përfundimin se vdekja që prekte pasardhësit e Adamit ishte një ndëshkim për mëkatin fillestar. Në një futnot ai u përpoq ta justifikonte këtë zëvendësim duke pohuar se Pali në këtë pasazh kishte përdorur një metonomi, d.m.th., kishte zëvendësuar shkakun me pasojën. Mëkati i Adamit ishte shkak i vdekshmërisë së tij dhe përmes tij po ashtu edhe shkak i vdekjes së pasardhësve të tij.

Ngjashëm me të parën edhe perifrazimi, nga ana e Lokut, i pasazhit 5:19 është si vijon: “Sepse për shkak të mosbindjes së një njeriu shumë të tjerë u dërguan në gjendjen e vdekshmërisë e cila i përket mëkatarëve, ngjashëm përmes bindjes së një njeriu të vetëm shumë të tjerë do të bëhen të drejtë, d.m.th. do të kthehen në jetë sikur të mos kishin qenë mëkatarë” (Loku 1987 [1707], f. 525). Fusnota përligjëse për këtë perifrazim është e përmbledhur dhe shfaqet si vijon: “*Mëkatarë*: këtu Shën Pali përdor të njëjtën metonimi si në versetin 12 duke zëvendësuar termin *mëkatarë* me termin *të vdekshëm* përmes së cilës antiteza me të drejtët bëhet më e gjallë” (f. 527). Nëse do ta konsiderojmë metoniminë e Lokut si në vija të përgjithshme të pranueshme, atëherë mund që gjithnjë të perifrazojmë diskutimin për mëkatin e Adamit si shkaktar transmetimit të tij tek pasardhësit e Adamit në favor të konceptit se ky mëkat i bëri pasardhësit e tij të vdekshëm, duke prerë në këtë mënyrë çdo mbështetje shkrimore që shkon në favor të konceptit Agustinian për mëkatin. Fatkeqësisht, shumë shkollarë biblikë e mohojnë faktin që strategjia e Lokut mund të jetë njëtrajtshmërisht e suksesshme.

Mund të themi se jemi të justifikuar në refuzimin e konceptit Agustinian për mëkatin fillestar, paçka se nuk dimë se ç’qëndrim të mbajmë për ato pasazhe shkrimore të cilat duket se janë në mbështetje të kësaj teorie. Kanti, në veprën e tij “Religjioni brenda kufijve të arsyes”, e mohoi doktrinën e fajit dhe mëkatit fillestarë duke u shprehur se: “Ciladoqoftw origjina dhe përbërja e ligësisë morale tek njeriu, padyshim që midis morisë të shpjegimeve për përhapjen e saj në të gjithë anëtarët dhe gjeneratat e gjinisë sonë njerëzore, më e papërshtatshme nga të gjitha është ajo teori e cila e përshkruan (mëkatin) si të zbritur tek ne në formën e një *trashëgimie* nga prindërit tanë të parë” (Kanti 1960 [1793], f. 35). Kanti, në filozofinë e tij të fesë, ofron një zëvendësues për doktrinën e mëkatit fillestarë. Kjo është doktrina e tij e ligësisë radikale në qenien njerëzore. Sipas tij, tek çdo njeri, për aq sa na lejohet të themi, gjendet një ligësi morale, apo një prirje për të keqen të cilën ai në një rast e ka quajtur edhe *peccatum originarium*.

Një prirje, sipas këndvështrimit të Kantit, është predispozicion për të kërkuar një kënaqësi e cila, pasi të jetë përjetuar, do të lerë tek zotëruesi një prirje drejt saj. P.sh., njerëzit me një prirje të zhvilluar për

një pije alkoolike, nuk e dëshirojnë pijen nëse nuk e kanë provuar më parë, por pasi ta kenë bërë këtë ata zhvillojnë një dëshirë për pijet alkoolike. Kanti i konsideronte prirjet e këtij lloji si diçka biologjike për shkak se ato i përkasin atij grupi njerëzish të cilët shihen si të përcaktuar nga ligjet e natyrës. Meqenëse gjërat e vendosura nga ligjet fikse të natyrës nuk përfshihen nga sfera morale, atëherë edhe prirjet natyrore duhen parë si moralisht neutrale. Kështu që, nëse të gjitha prirjet në qeniet njerëzore janë fizike, atëherë edhe prija humane drejt të keqes nuk mund të konsiderohet në vetvete si një e ligë morale. Që të ekzistojë e keqja morale duhet që fillimisht të ekzistojnë, brenda njeriut, prirjet jo fizikisht të përcaktuara drejt së keqes. Sipas Kantit, moralisht e gabuar është çdo gjë që vjen si pasojë e veprimit të lirë njerëzorë, kështu që një prirje moralisht e ligë drejt së keqes duhet të jetë rezultat i ushtrimit të lirisë nga ana e njeriut. Kanti na mëson se, ndonëse prirja drejt së ligës mund të përshkruhet si e lindur tek njeriu, gjithsesi ajo nuk duhet paraqitur thjesht në këtë formë, por mund të përshkruhet edhe si një gjendje e vetshkaktuar nga njerëzit mbi vetet e tyre. Prirja drejt së ligës mund të paraqitet si e lindur sepse, ngjashëm si tekstura e të gjitha veprimeve të liga moralisht në jetën njerëzore, ajo duhet parë si e ekzistente para të gjitha veprimeve të liga dhe ngjashëm ekzistuese në kohë që në lindjen e njeriut. Prirja drejt së ligës mund të paraqitet si një diçka vetshkaktuar nga njerëzit mbi vetet e tyre sepse që një veprim të quhet moralisht i ligë nevojitet që ai të jetë fryt i lirisë njerëzore falë së cilës zotëruesi i saj (njeriu) konsiderohet përgjegjës për veprimet e tij. Po ashtu, prirja drejt së ligës mund të shihet si një diçka e shkaktuar nga njeriu mbi veten e tij, sepse kjo prirje mund të paraqitet si, dhe në fakt është, një produkt jokohorë i lirisë noumenale nga ana e zotëruesit të saj.

Sipas këndvështrimit të Kantit, tek çdo qenie njerëzore gjendet një prirje e natyrshme drejt së ligës në kuptimin që, për aq sa na lejohet të themi, çdo njeri përmes një akti noumenal të lirë ka sjellë mbi veten e tij prirjen moralisht të ligë për të bërë keq. Kjo prirje nuk na është trashëguar nga paraardhësit tanë të hershëm, si dhe nuk është dhunti gjenetike që na është transmetuar nga riprodhimi seksual. Po ashtu ajo nuk është diçka që na është ngarkuar nga Perëndia. Për shkak se ajo është produkt i lirisë noumenale ne konsiderohemi përgjegjës dhe fajtor për prurjen e saj në qenien tonë. Nëse ideja kantiane e të ligës radikale është filozofikisht më e pranueshme se ajo e mëkatit fillestarë të shtjelluar nga Agustini varet kryesisht nga besueshmëria e supozimeve të Kantit sipas së cilave ekzistojnë veprime jokohore me karakter noumenal të lirë. Shumë filozofë e shohin këtë teori si të pagjasë.

Në librin e tij “Koncepti i ankthit”, Vigilius Haufniensis, i njohur si Soren Kierkegard, solli një shqyrtim të thjeshtë psikologjik rreth mëkatit të trashëguar. Përfundimi i këtij shqyrtimi ishte se nuk ekziston asnjë i ashtuquajtur mëkat fillestarë. Kierkegardi këmbëngulte se çdo njeri fillimisht lind i pafajshëm. Për çdo qenie njerëzore, “pafajësia humbet falë kapërcimit cilësor të individit” dhe “faji depërton në kapërcimin cilësorë” (Kierkegard 1980 [1844], f. 37, 41). Ngjashëm si veprimet e lira noumenale të Kantit, kapërcimet cilësore nuk janë të përcaktuara në formë shkakësore e për këtë arsye atyre nuk mund ti japim një shpjegim shkencorë të përcaktuar. Sipas Kierkegardit, ne jemi si Adami dhe Eva sepse të gjithë ne kërcejmë nga pafajësia në mëkat dhe asgjë e trashëguar nuk është përgjegjëse për dërgimin e vetëve tona në buzë të greminës. Kierkegardi shprehej se: “një individ mund të thotë në sineritet të plotë se ai është lindur në mizëri dhe se nëna e tij e konceptoi atë në mëkat, por ai mund të shfaq pikëllim për këtë gjë vetëm nëse vetë ai ka sjellë mëkatin në botë dhe të gjithë këtë e ka sjellë mbi veten e tij” (f. 38). Kështu që, sipas tij, ne konsiderohemi fajtorë vetëm kur veprojmë mëkate individuale, të cilat janë kapërcime të lira cilësore në drejtimin e gabuar dhe për hir të së cilave ne mund të konsiderohemi moralisht përgjegjës.

Ndonëse ideja e mëkatit fillestar nuk ka qenë një çështje kryesore në filozofinë e fesë së shekullit të njëzet, përsëri filozofë të krishterë të tillë si Richard Swinburne kanë sjellë argumente të reja kundër

konceptit të Agustinit. (Swinburne 1989, kap. 9). Ai pranon faktin se prirja drejt mëkatit është e lindur në qeniet njerëzore, ajo buron nga dëshirat e fuqishme të cilat janë pjesë e trashëgimisë sonë evolutive. Për shkak se, njësoj si Kanti dhe Kierkegardi, ai mbështet konceptin liberal për lirinë, ai këmbëngul se dëshirat e liga nga të cilat përbëhet prirja drejt së keqes e bëjnë njeriun të anojë drejt keqdhëzimit por nuk kanë statusin e domosdoshmërisë për këtë arsye këto prirje nuk të dërgojnë medoemos drejt veprimit të gabuar. Swinburn-i e mohon në mënyrë të fuqishme doktrinën e mëkatit të trashëguar, sipas së cilës të gjithë pasardhësit e Adamit janë fajtorë dhe mëkatarë për mëkatin e parë të kryer nga Adami. Askush, shprehet Swinburn-i, nuk duhet konsideruar përgjegjës për mëkatet e një tjetër personi, përveç nëse ai ka qenë përgjegjës për frenimin e mëkatarit dhe nuk e ka bërë këtë. Meqenëse asnjëri prej nesh nuk mund të ketë qenë përgjegjës për frenimin e Adamit dhe Evës nga kryerja e mëkatit fillestar atëherë askush nuk mund të na konsideroj fajtor për mëkatin e tyre. Swinburn-i këmbëngul se qëndrimi i tij është i bazuar në tekstin e shkrimit të shenjtë: “Shpirti që mëkaton do të vdesë, i biri nuk do të mbartë paudhësinë e atit dhe ati nuk do të mbartë paudhësinë e birit; drejtësia e të drejtit do të jetë mbi të, pabesia e të pabesit do të bien mbi të.” (Ezekiel 18:20). Sipas Swinburn-it i vetmi përjashtim ndaj këtij rregull shfaqet atëherë kur ne dhunojmë obligimin për të ndaluar të tjerët nga keqveprimi.

Sipas mendimit tim, kritikët e doktrinës së Agustinit janë të saktë në pohimin e tyre se qeniet njerëzore nuk mund të konsiderohen mëkatarë apo fajtorë për mëkatin e fillestarë të kryer nga çifti i parë njerëzorë (shih Quinn 1992). Ne jemi fajtor vetëm për veprimet tona moralisht të liga, prandaj ne bëhemi fajtor vetëm pasi kemi kryer mëkate personale. Të krishterët të cilën ndajnë të njëjtin mendim duhet gjithashtu të ndajnë të njëjtin mendim edhe me shqetësimin e Lokut për të interpretuar versetet e tilla si 5:12 dhe 5:19 në një mënyrë e cila nuk mbështet doktrinën e Agustinit.

Përktheu: Rezart Beka

## Bibliografi

- Anselm of Canterbury: *Why God Became Man and the Virgin Conception and Original Sin* (1100), përkthyer nga J. M. Colleran (Albany: Magi Books, 1969)
- Agustin of Hippo: *City of God* (426). Përkthyer nga G. G. Walsh, D. B. Zema, G. Monahan, dhe D. J. Honan (Garden City: Doubleday, 1958)
- Edwards, J.: *Original Sin* (1758), ed. C. A. Holbrook (New Haven and London: Yale University Press, 1970)
- Kant, I.: *Religion within the Limits of Reason Alone* (1793), përkthyer nga T. M. Greene dhe H. H. Hudson (New York: Harper & Brothers, 1960).
- Kierkegaard, S.: *The Concept of Anxiety* (1844), përkthyer nga R. Thomte (Princeton University Press, 1980).
- Locke, J.: *A Paraphrase and Notes on the Epistles of St. Paul* (1707), ed. A. W. Wainwright (Oxford: Clarendon Press, 1987)
- Quinn, P. L.: “On demythologizing evil” In *Discourse and Practice*, ed. F. Reynolds dhe D. Tracy (Albany: State University of New York Press, 1992), f. 111-40
- Swinburne, R.: *Responsibility and Atonement* (Oxford: Clarendon Press, 1989).

## Date Created



12/10/2014

**Author**

erasmusi